VENDIM
Nr. 294, datë 14.5.2014

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, t'i shtohet fondi prej 165 milionë lekësh, përkatësisht:

a) Në programin "Planifikimi urban dhe strehimi", për Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, në zërin "Investime" t'i shtohet fondi prej 162 milionë lekësh, me qëllim blerjen e mjeteve të rënda;

b) Në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, në zërin "Mallra dhe shërbime", t'i shtohet fondi prej 3 milionë lekësh, me qëllim prodhimin e veshjeve për vullnetarët dhe të fletëpalosjeve.

2. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin "Forcat e luftimit", artikulli 602, reparti ushtarak 1001, Forca Tokësore, t'i shtohet fondi prej 30 milionë lekësh, me qëllim mbulimin e shpenzimeve me ushqim dhe fjetje, karburant dhe shpenzime transporti, si dhe nukle sanitare dhe tualete portabël për Forcat e Armatosura.

3. Fondi shtesë prej 195 milionë lekësh të përballohet nga pakësimi i fondeve buxhetore të institucioneve për shpenzimet kapitale dhe korrente, për vitin 2014, sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr.1

leke

		Investime	Korrente
5	**Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujrave**	**21.000.000**	**3.000.000**
04240	*Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes*	20.000.000	
04250	*Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.*	1.000.000	
6	**Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës**	**40.000.000**	
04520	*Transporti rrugor*	40.000.000	
10	**Ministria e Financave**	**5.000.000**	
01110	*Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi*	5.000.000	
11	**Ministria e Arsimit**	**27.000.000**	
09120	*Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)*	15.000.000	
09230	*Arsimi i Mesem (i pergjithshem)*	10.000.000	
09240	*Arsimi i Mesem (profesional)*	2.000.000	
13	**Ministria e Shëndetësisë**	**12.000.000**	
07220	*Sherbimet e Kujdesit Paresor*	2.000.000	
07330	*Sherbimet e Kujdesit Dytesor*	10.000.000	
14	**Ministria e Drejtësisë**	**10.000.000**	
01110	*Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi*	10.000.000	
16	**Ministria e Punëve të Brendshme**	**15.000.000**	
03140	*Policia e Shtetit*	15.000.000	
17	**Ministria e Mbrojtjes**	**25.000.000**	
02120	*Forcat e luftimit*	25.000.000	
26	**Ministria e Mjedisit**	**5.000.000**	
04260	*Administrimi i Pyjeve*	5.000.000	
93	**Ministria e Energjisë dhe Industrisë**	**2.000.000**	
04430	*Mbeshtetje per Burimet Natyrore*	2.000.000	
50	**Instituti Statistikes**		**20.000.000**
01320	*Veprimtaria Statistikore*		
18	**Sherbimi Informativ Shteteror**		
03520	*Veprimtaria Informative Shteterore*		**10.000.000**
	Totali	**162.000.000**	**33.000.000**